

VENDIM
Nr. 88, datë 24.2.1997

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTMARRËVESHJES PËR BASHKËPUNIMIN
FINANCIAR NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR PROJEKTIN E PLANIFIKIMIT
FAMILJAR**

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ambientit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të projektmarrëveshjes për bashkëpunim financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin e planifikimit familjar, me ndryshimin e nenit 3 si vijon:

“Qeveria shqiptare merr përsipër pagesën e taksave dhe tatimeve për mallrat që do të livrohen në kuadrin e kësaj marrëveshjeje, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë”.

2. Autorizohet Ministri i Shëndetësisë dhe i Ambientit, ose i autorizuari i tij, të nënshkruajë marrëveshjen e bashkëpunimit financiar në emër të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë.

3. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe e Ambientit të ndjekë zbatimin e projektit të planifikimit familjar.

4. Ngarkohet Ministria e Financave të parashikojë në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ambientit fondet e nevojshme për mbulimin e detyrimeve sipas nenit 3 të projektmarrëveshjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi